



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 55, Datë 16.02.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM NË
GJYKATËN E LARTË, TË KANDIDATËVE NGA RADHËT E GJYQTARËVE,
PËR NJËMBËDHJETË POZICIONET E SHPALLURA TË LIRA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për emërim sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:
 - a) Për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative - relatore znj. Marçela Shehu;
 - b) Për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile - relator z. Alban Toro;
 - c) Për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale - relator z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR